



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2019:090574

Datë: 21.01.2026

Numri i dokumentit: 08342688

Rev.nr.216/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Milena Gjeriq dhe Nenad Lazic, anëtar në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.D., “.....” nr. ..., P, Dardafon.net LLC, me seli në Fushë Kosovë, fshati, rr. “.....” nr..., dhe Abrazon Ish Devolli Group shpk, me seli në I., rr. “...” nr... dhe Abrazen LLC(ish Devolli Grup shpk), të cilët i përfaqëson Faton Qirezi avokat në Prishtinë, kundër të paditurve Radio Televizioni “Dukagjini” rr. “Ismail Qemalli” nr. 2, të cilën e përfaqëson Dastid Pallaska, avokat në Prishtinë, e paditura N.B Media Works SH.P.K, me seli në Prishtinë rr.“Perandori Justinian” nr.69, të cilën e përfaqëson Granit Vokshi, avokat në Prishtinë, ndërhyrësve të thjeshtë në anë të paditësve A.D., N.D., A.D., N.D., A.D., I.D., A.D., Sh.D., K.D., G.D., N.D., E.D., A.D, T. D., L.D., A.D., A.D., V.D., E.D., B.D., K.D., A.D., A.D., D.D., E.D., dhe R.D., të gjithë nga P., të cilët i përfaqëson Alban Makolli avokat në Prishtinë, objekti i kontestit kompensim dëmi për shkak të shpifjes dhe fyerjes, vlera e objektit të kontestit 200.000€, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditësve, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5319/2021 të datës 05.11.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 19.01.2026, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pa bazuar revizioni i të autorizuarit të paditësve B.D., etj, të gjithë nga P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5319/2021 të datës 05.11.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, me numër C.nr.784/17, datë 12.04.2021, është vendosur të refuzoj kërkesëpadinë e paditësve B.D., nga ..., rr. “H. P” ., nr. ..., Dardafon.net LLC, me seli në Fushë Kosovë, fshati, rr. “.....” nr..., dhe Abrazen LLC me seli në I., rr. “...” nr. ... (ish Devolli Grup sh.p.k), me të cilën kanë kërkuar që të VËRTETOHET se përmbajtja e Emisionit Zona Express me titull “Devollistan” i dt. 30.04.2017, prodhim i N.B Media Works SH.P.K P., i transmetuar nga Radio Televizioni Dukagjini, rr. Ismail Qemali nr.2, Pejë, është

me përmbajtje shpifëse dhe fyese dhe të DETYROHEN të paditurit : Radio Televizioni Dukagjini , me adresë Ismail Qemaili nr.2, që në Pejë, dhe N.B Media Ēorks SH.P.K Prishtinë rr. “Perandori Justinian” nr.69, në emër të kompensimit të dēmit moral për shkak të shpifjes dhe fryrjeve , në mënyrë solidare t’ia paguajnë shumën prej 200.000 € (dyqindën mijë euro), dhe paditēsit B.D., shumën prej 100.000€, ndērsa paditēsit të dytë dhe të tretë nga 50.000 €, si dhe të detyrohen të paditurat që të largojnë emisionin “Devollistan,, nga YouTube, nga mediat sociale, si dhe nga çdo faqe të internetit ku kanë publikuar, dhe në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e tilla shpifēs dhe fyese ndaj paditēsve, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmērisē sē kētij aktgjykimin e nēn kērcenim të përmbarimit me dhunē, si dhe të detyrohen të paditurat , që paditēsve solidarisht t’ia paguajnë shpenzimet e procedurēs në shumë prej 5.606.25 € (pesē mijē e gjashtëqindën e gjashtëdhjetē euro, e njēzet e pesē centē), në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmērisē sē kētij aktgjykimi e nēn kērcēnim të përmbarimit me dhunē , si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit të Kosovēs, duke vendosur sipas ankesēs sē paditēsve, me aktgjykimin Ac.nr.5319/2021 të datēs 05.11.2024, ka refuzuar të pathemeltē ankesēn e paditēsve, ndērsa aktgjykimin e Gjykatēs Themelore në Pejë - Departamenti i Pērgjithshēm, C.nr.784/17, datē 12.04.2021, e ka vērtetuar.

Kundēr aktgjykimit të gjykatēs sē shkallēs sē dytē paditēsi pērmes të autorizuarit të tij në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurēs kontestimore dhe aplikimit të gabuar të sē drejtēs materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovēs të pranoj revizionin e paditēsve, të prishē aktgjykimet e Gjykatēs sē Apelit ndērsa kompetent për të vendosur në kētē çēshtje të shpallet Gjykata Komerçiale-Dhomat e shkallēs sē Dytē.

I autorizuari i të paditurēs sē parē ka paraqitur pērgjigje në revizion, me propozim që revizioni të refuzohet i pathemeltē.

Gjykata Supreme e Kosovēs, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurēn Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionin e palēs paditēse, si dhe shkresat e lēndēs dhe gjeti se:

Revizioni i paditēsve ēshtë i pathemeltē.

Nga shkresat e lēndēs rezulton se paditēsit, pērmes të autorizuarit të tyre, me datēn 02.08.2017, në gjykatēn e shkallēs sē parē kanë paraqitur padi kundēr të paditurve, duke kērkuar të vērtetohet se të paditurat kanë shpifur dhe fyer në drejtim të paditēsve. Kēto veprime nga ana e të paditurve kanë ndodhur në atē mënyrē që kanë transmetuar emisionin e quajtur “Devollistan” me datē 30.04.2017. Publikimi i tillē sipas paditēsve ka përmbajtur shumë të pavērteta dhe shpifje, me qëllime tendencioze që të njolloste emrin e paditēseve, për të cilat pretendime, të paditurit nuk ishin bazuar në të dhēna reale. Ata fillimisht kanë kērkuar vērtetimin e faktit se të paditurit kanë shpifur, mē pas kompensimin e dēmit në lartēsi 5,000,000.00€.

Gjykata e shkallēs sē parē ka refuzuar kērkēsēpadinē e paditēsve me arsyetim se ka administruar provat e paraqitura nga palēt ndērgjyqēsē dhe se ēshtë shqyrtuar emisioni i kontestuar gjegjēsisht transkripti i emisionit të datēs 30.04.2017 po ashtu shprehjet e pērdorura në atē emision, duke arritur në pērfundim se përmbajtja e tij, nuk pērbēn shpifje dhe fyerje në Kuptim të LSHF-sē.

Më tej ka arsyetuar se përdorimi i fjalëve të pretenduar nga paditësit si shpifje dhe fyese, për veç se nuk cilësohen si shpifëse, nuk mund të cilësohen as si fyese, për faktin se janë ngjarje të njohura për opinionin publik dhe të ngritura me vite neper emisione të ndryshme televizive, në debate parlamentare, nga krerët e shtetit të Kosovës, nga krerët e partive politike opozitare, dhe për këto ishte ngrit aktakuzë nga Prokuroria Speciale e Kosovës. Mbi të gjitha edhe pse paditësit pretendojnë, se të gjitha këto ishin sqaruar dhe vendosur në favorin e tyre me Aktgjykimin lirues të Gjykatës së Qarkut Prishtinë P.nr 279/2012 datë 28.06.2013, Gjykata mendon se këto janë çështje të ndjeshme, shqetësuese dhe në vete përmbajnë shqetësim të brendshëm shpirtëror dhe prek personalitetin e çdo personi, e jo vetëm të paditësve, mirëpo pavarësisht kësaj nuk mund të thuhet se kanë përmbajtur shpifëse dhe fyese, pra emisioni i kontestuar nuk i dedikohet vetëm paditësve, por janë të përfshirë edhe krerët e partive politike.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ju ka referuar dispozitave të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

Gjykata e Apelit, duke shqyrtuar pretendimet ankimore për ekzistimin e shkeljeve esenciale të dispozitave procedural të ngritura nga paditësit, vlerësoi se këto pretendime nuk qëndrojnë, kjo pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se procedura para gjykatës së shkallës së parë është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me dispozitat përkatëse procedurale, ku palëve u është mundësuar ushtrimi i të gjitha të drejtave procedurale, përfshirë të drejtën për të propozuar prova dhe për t'u deklaruar lidhur me to. Vendimi i ankimuar përmban arsye të qarta dhe të mjaftueshme mbi faktet vendimtare të çështjes, si dhe mbi bazën ligjore të vendimmarrjes, andaj nuk mund të konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka bërë në shkelje esenciale të dispozitave procedural nga neni 182.2 të LPK-së.

Në vlerësim të pretendimeve për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit konstatoi se gjykata e shkallës së parë ka bërë një analizë të gjithanshme të provave të administruara, duke i vlerësuar ato si në mënyrë të veçantë edhe në ndërlidhje me njëra-tjetrën. Në mënyrë të veçantë janë vlerësuar transkripti i emisionit të kontestuar, provat dokumentare që ndërlidhen me procedurat penale të zhvilluara më herët, si dhe rrethanat tjera që tregojnë se temat e trajtuara në emision kanë qenë objekt diskutimi edhe në rrafsh të tjera publike dhe institucionale. Pala ankuese nuk ka arritur të konkretizojë se cilat prova janë vlerësuar gabimisht apo cilat fakte vendimtare nuk janë vërtetuar, e që do të kishin ndikuar në një përfundim tjetër lidhur me gjendjen faktike, andaj këto pretendime janë vlerësuar si të pabazuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndonëse kjo gjykatë kujdeset për aplikimin e saj edhe sipas detyrës zyrtare, Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt dispozitat e Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke pasur parasysh përmbajtjen e deklarimeve të kontestuar, kontekstin në të cilin ato janë dhënë, interesin publik të çështjes, si dhe statusin e paditësve si subjekte me ndikim të theksuar ekonomik, gjykata e shkallës së parë drejt ka arritur në përfundimin se shprehjet e përdorura nuk përbëjnë shpifje apo fyerje në kuptim të ligjit. Për rrjedhojë, refuzimi

i kërkesëpadisë është vlerësuar si i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa pretendimet ankimore të paditësve janë konsideruar të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë, pasi që aktgjykimi nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Paditësit si shkak për paraqitjen e revizionit përdorin çështjen e kompetencës lëndore të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë për të vendosur lidhur me këtë çështje. Gjykata Supreme vlerëson se ky pretendim nuk mund të shqyrtohen në procedurën sipas mjetit juridik të jashtëzakonshëm revizionit, pasi që sipas nenit 214.1 të LPK-së revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të shkeljeve të parapara në nenin 182 paragrafi 2 pikat (f, h, i dhe m) të LPK-së. Ku në pikën f) është përcaktuar se: “në coftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është me kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata llojit tjetër”.

Në revizion është pretenduar se gjykatat e shkallës më të ulët kanë bërë shkelje të dispozitave nga nenet 194 dhe 182.2, pika n) të LPK-së. Paditësit në revizion theksojnë se Gjykata e Apelit nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe se arsyetimi i saj është i përgjithshëm dhe formal. Gjykata Supreme vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, ngase nga shqyrtimi i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit rezulton se kjo gjykatë ka shqyrtuar çështjen brenda kufijve të ankesës, ashtu siç kërkohet nga neni 194 i LPK-së. Gjykata e Apelit ka dhënë arsye të mjaftueshme pse i ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditësve për shkelje të dispozitave procedurale, mungesës së arsyetimi dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata Supreme vlerëson se nga aktgjykimi i atakuar me revision rezulton se çështjet thelbësore janë trajtuar, ndërsa LPK nuk kërkon që gjykata e ankimit t’i përgjigjet në mënyrë të veçantë dhe të detajuar secilit pretendim apo secilës fjali të ankesës, por që arsyetimi i gjykatës duhet të jetë i qartë, logjik dhe i mjaftueshëm për të kuptuar bazën faktike dhe juridike të vendimit.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët kanë dhënë arsye në lidhje me faktet vendimtare e që kanë të bëjnë me përmbajtjen e emisionit të kontestuar, kontekstin në të cilin janë dhënë deklaratimet, natyra e deklaratave të kontestuar, nëse paraqesin pohime faktike apo vlerësime dhe opinione; rolin e të paditurave si ofruese të shërbimeve mediale dhe statusi i paditësve si subjekte juridike dhe fizike me ndikim të theksuar ekonomik dhe publik, ekzistenca e procedurës penale të mëhershme, përfshirë aktgjykimin lirues. Janë dhënë arsye të qarta pse deklaratimet janë cilësuar si pjesë e debatit publik dhe si vlerësime editoriale, e jo si shpifje apo fyerje në kuptim të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykatat kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse, mbi bazën e këtyre fakteve, përmbajtja e emisionit të kontestuar nuk përbën shpifje apo fyerje në kuptim të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

Sa i përket Vendimit të KPM-së dhe aktgjykimit penale të përmendura nga paditësit, Gjykata Supreme rikujton se vendimet e organeve administrative nuk e lidhin gjykatën civile në mënyrë

automatike. Gjykata ka detyrim t'i vlerësojë provat në mënyrë të pavarur, në përputhje me nenin 8 paragrafi 2 të LPK-së, kurse fakti që një provë nuk është pranuar si vendimtare nuk do të thotë se ajo nuk është marrë në konsideratë nga gjykata.

Gjykata Supreme konstaton se pjesa dërrmuese e pretendimeve të revizionit synojnë rishqyrtimin e secilit deklaram individual, rivlerësimin e provave dhe ndërtimin e një gjendjeje tjetër faktike. Këto pretendime nuk mund të shqyrtohen në procedurën sipas mjetit juridik të jashtëzakonshëm revizionit, pasi që sipas nenit 214.2 të LPK-së revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Në raport me pretendimet që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të drejtës materiale. Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta kanë zbatuar drejt dispozitat e Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, duke e bërë dallimin ndërmjet deklaratave faktike dhe vlerësimeve, opinioneve dhe qëndrimeve editorial, marrë parasysh se çështja ka të bëjë me interes publik dhe me persona me ndikim publik. Janë aplikuar standardet e përgjegjësisë së mediave në përputhje me praktikën e GjEDNJ-së (rastet *Lingens kundër Austrisë, etj.*), ku sipas kësaj praktike liria e shprehjes mbrohet edhe deklarime që mund të jenë shqetësuese, provokuese apo kritike. Kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjerë ndaj personave publikë, ndërsa mediat gëzojnë një shkallë të lartë mbrojtjeje kur veprojnë në kuadër të debatit publik.

Në këtë kontekst, nuk është konstatuar ekzistenca e veprimit të kundërligjshëm si parakusht për përgjegjësi civile sipas LMD-së.

Po ashtu me nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet se: "1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare." Ndërsa me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcaktohet se: "Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshinë lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që tu kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimi audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund tu nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratikë, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënëve konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor".

Në rrethana e rastit konkret, Gjykata Supreme vlerëson se përmbajtja e emisionit të kontestuar, e shqyrtuar në tërësinë e saj dhe në kontekstin në të cilin është publikuar, nuk përmban deklarime shpifëse apo fyese në kuptim të nenit 3 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Shprehjet dhe vlerësimet e përdorura nuk përbëjnë paraqitje të fakteve të pavërteta të paraqitura si të

vërteta, por trajtojnë çështje të interesit të përgjithshëm dhe përmbajnë vlerësime, opinione dhe qëndrime editoriale të bazuara në ngjarje, debate publike, deklarime institucionale dhe zhvillime që në kohën e publikimit kanë qenë objekt diskutimi të gjerë shoqëror dhe institucional. Duke pasur parasysh statusin publik dhe ndikimin ekonomik të paditësve, kufijtë e kritikës së pranueshme ndaj tyre janë më të gjerë, ndërsa ndërhyrja në lirinë e shprehjes së medias do të ishte joproporcionale dhe jo e domosdoshme në një shoqëri demokratike. Për rrjedhojë, në mungesë të elementeve përbërëse të shpifjes dhe fyerjes, si dhe duke marrë parasysh standardet e vendosura nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kërkesëpadia e paditësve nuk gjen mbështetje faktike dhe juridike dhe si e tillë me të drejtë është refuzuar.

Në rrethana të tilla janë vlerësuar të paqëndrueshme pretendimet në revizion për shkelje të drejtës materiale, respektivisht mosinterpretimin e drejtë të dispozitave ligjore të lartcekura nga instancat më të ulëta, kjo pasi gjykatat e instancës më të ulët, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesëpadinë e paditësit drejtë kanë zbatuar edhe të drejtën materiale.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 222 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.216/2025, më 19.01.2026

Kryetari i Kolegjit- Gjyqtari

Zenel Leku